

# **Riklasifikimi i Aktiveve Financiare**

Ndryshim

SNK 39 dhe SNRF 7

# **Riklasifikimi i Aktiveve Financiarë (Përmirësime për SNK 39 Instrumentat Financiarë: Njohja dhe Matja dhe SNRF 7 Instrumentat Financiarë: Dhënia e Informacioneve Shpjeguese)**

## **Ndryshimet për SNK 39**

Paragraph 50 është ndryshuar dhe janë shtuar paragrafët 50B – 50F dhe 103G. added.

## **Matja**

### **Riklasifikimet**

#### **50 Një Njësi:**

- (a) nuk do ta riklasifikojë një derivat me një vlerë të ndryshme nga vlera e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes për sa kohë ky instrument financiar është ende gjendje ose sapo është emetuar, pra ky instrument financiar nuk do të ndryshojë kategorinë derisa të ekzekutohet.
- (b) nuk do të riklasifikojë asnjë instrument financiar me një vlerë të ndryshme nga vlera e drejtë nëpërmjet kategorisë së fitimit ose humbjes, në qoftë se në njohjen e tij fillestare është regjistruar nga njësia me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes: dhe
- (c) mundet, nëse një aktiv financiar nuk mbahet për një kohë të gjatë për qëllim shitje ose riblerje në periudhën e afërt (pavarësisht se aktivi financiar mund të jetë blerë që në fillim për qëllime të shitjes ose të riblerjes në periudhën afatshkurtër), riklasifikimi do të bëhet për një vlerë të ndryshme nga vlera e drejtë nëpërmjet kategorisë së fitimit ose humbjes vetëm nëse aktivi financiar plotëson kriteret e paragrafëve 50B dhe 50D.

**Një njësi nuk duhet të riklasifikojë asnjë instrument financiar në vlerën e drejtë nëpërmjet kategorisë së fitimit ose humbjes, pas njohjes fillestare.**

- 50B Një aktiv financiar për të cilin aplikohet paragrafi 50(c) (përveç aktiveve financiare të tipit sipas përshkrimit në paragrafin 50D) mund të riklasifikohen me një vlerë të ndryshme nga vlera e drejtë nëpërmjet kategorisë së fitimit ose humbjes vetëm në rrethana të rralla.
- 50C Nëse një njësi i riklasifikon aktivet financiare me një vlerë të ndryshme nga vlera e drejtë nëpërmjet kategorisë së fitimit ose humbjes në përputhje me paragrafin 50B, aktivet financiare do të riklasifikohen me vlerën e tyre të drejtë në datën e riklasifikimit. Nëse ka patur fitim ose humbje të regjistruar në llogarinë fitim ose humbje, kjo vlerë nuk do të rimerret. Vlera e drejtë e aktiveve financiare në datën e riklasifikimit bëhet kostoja e tij e re ose kosto e amortizuar, ashtu si zbatohet.
- 50D Një aktiv financiar për të cilin aplikohet paragrafi 50(c) i cili mund të ketë plotësuar përkufizimin e huave dhe të drejtave (në qoftë se një aktiv financiar nuk është kërkuar të klasifikohet si i mbajtur për tregtim në regjistrimin e saj fillestar) mund të riklasifikohet me një vlerë të ndryshme nga vlera e drejtë nëpërmjet kategorisë së fitimit ose humbjes nëse njësia ka për qëllim dhe kompetencë t'i mbajë aktivet financiare për të ardhmen e parashikuar ose për mbajtjen e tyre deri në maturim.
- 50E Një aktiv financiar i klasifikuar si i vlefshëm për shitje që plotëson përkufizimin e huasë dhe të drejtave (nëse nuk është klasifikuar si i vlefshëm për shitje) mund të riklasifikohet në një kategori të ndryshme nga ajo e vlefshme për shitje, në kategorinë e huave dhe të drejtave, nëse njësia ka për qëllim dhe mundësi t'i mbajë këto aktive financiare për të ardhmen e parashikuar ose deri në maturim.
- 50F Nëse një njësi e riklasifikon një aktiv financiar me një vlerë të ndryshme nga vlera e drejtë nëpërmjet kategorisë së fitimit ose humbjes në përputhje me paragrafin 50D ose në një kategori të ndryshme nga kategoria i vlefshëm për shitje në përputhje me paragrafin 50E, ajo do ta riklasifikojë aktivin financiar me vlerën e tij të drejtë në datën e riklasifikimit. Për një aktiv financiar të riklasifikuar në përputhje me paragrafin 50D, nëse ka patur ndonjë fitim ose humbje ndërkohë, ajo nuk do të rimerret. Vlera e drejtë e aktivit financiar në datën e

riklasifikimit është kostoja e tij e re ose kosto e amortizueshme, sipas zbatueshmërisë. Për aktivet financiarë të riklasifikuar në një kategori të ndryshme nga kategoria i vlefshëm për shitje, në përputhje me paragrafin 50E, ndonjë fitim ose humbje të mëparshme të këtij aktivi e regjistruar në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve në përputhje me paragrafin 55(b), do të kontabilizohet në përputhje me paragrafin 54.

## Data efektive e Kalimit

---

103G *Riklasifikimi i Aktiveve Financiare* (Shtesa për SNK 39 dhe SNRF 7), i publikuar në Tetor 2008, është ndryshuar paragrafi 50 dhe AG8, dhe janë shtuar paragrafët 50B-50F. Një njësi do t'i aplikojë këto ndryshime nga 1 Korrik 2008. Një njësi nuk do ta riklasifikojë një aktiv financiar në përputhje me paragrafin 50B, 50D ose 50E përpara 1 Korrik 2008. Ndonjë riklasifikim i aktiveve financiare i bërë në periudhën para ose pas 1 Nëntor 2008 do të ketë efekte vetëm nga momenti kur është bërë riklasifikimi. Ndonjë riklasifikim i një aktivi financiar në përputhje me paragrafët 50B, 50D ose 50E nuk do të aplikohet në mënyrë retrospektivë për periudhën raportuese që përfundon përpara datës efektive të vendosur në këtë paragraf.

Në Apendiksin A *Udhëzim mbi zbatimin*, është shtuar paragrafi AG8

## Norma efektive e interesit

AG8 Nëse një njësi rishikon parashikimin e saj të pagesave ose arkëtimeve, njësia duhet të rregullojë vlerën kontabël të aktivit financiar ose të detyrimit financiar (ose grup instrumentash financiarë) për të pasqyruar flukset aktuale dhe ato të parashikuara monetare. Njësia llogarit vlerën kontabël neto duke njehsuar vlerën aktuale të flukseve të pritshme me normën efektive të interesit në datën e emetimit të instrumentave financiarë. Regjistrimet rregulluese njihen si shpenzim ose si e ardhur në llogarinë fitim-humbje. Nëse një aktiv financiar është riklasifikuar në përputhje me paragrafët 50B, 50D ose 50E, dhe njësia më pas rrit flukset e pritshme monetare si rezultat i rritjes së arkëtimeve të pritshme. Efekti i kësaj rritjeje do të regjistrohet si regjistrim rregullues për normën efektive të interesit nga data e ndryshimit të flukseve dhe jo si një regjistrim rregullues për vlerën kontabël të aktivit në datën e ndryshimit të parashikuar.

## Ndryshimet për SNRF 7

Paragrafi 12 është ndryshuar dhe janë shtuar paragrafët 12A dhe 44E.

### Rëndësia e instrumentave financiarë për pozicionin financiar dhe performancës

#### Pasqyra e pozicionit financiar

##### Riklasifikimi

- 12 Nëse një njësi e ka riklasifikuar një aktiv financiar (në përputhje me paragrafët 51 – 54 të SNK 39) të vlerësuar me:
- (a) kosto ose kosto e amortizueshme, dhe jo me vlerën e drejtë, ose
  - (b) me vlerën e drejtë, dhe jo me koston ose koston e amortizueshme
- ajo duhet të japë shënime shpjeguese për vlerën me të cilën e ka regjistruar dhe e ka çregjistruar nga secila kategori dhe arsyet për këtë riklasifikim.
- 12A Nëse njësi e ka riklasifikuar një aktiv financiar më një vlerë të ndryshme nga vlera e drejtë nëpërmjet kategorisë së fitimit ose humbjes në përputhje me paragrafët 50B ose 50D të SNK 39, ose me në një kategori të ndryshme nga i vlefshëm për shitje në përputhje me paragrafët 50E të SNK 39, duhet të paraqesë në shënimet shpjeguese:
- (a) vlerën me të cilën e ka regjistruar ose e ka çregjistruar nga secila kategori
  - (b) për secilën periudhë raportimi deri në çregjistrim, vlera kontabël dhe vlera e drejtë për të gjithë aktivet financiarë të cilat janë riklasifikuar në periudhën aktuale dhe atë të mëparshme.
  - (c) nëse një aktiv financiar ka qenë i riklasifikuar në përputhje me paragrafin 50B, një situatë e rrallë, faktet dhe rrethanat tregojnë se situata është e rrallë.
  - (d) për periudhën raportuese kur aktivet financiarë janë riklasifikuar, vlera e drejtë krijon diferenca të cilat regjistrohen në fitim ose humbje në pasqyrën e rezultatit të periudhës aktuale ose në periudhën e mëparshme.
  - (e) për secilën periudhë raportuese që pason riklasifikimin (përfshirë periudhë raportuese në të cilën aktivi është riklasifikuar) deri në çregjistrimin e aktivit financiar, fitimi ose humbja e regjistruar në rezultat nëse aktivi financiar nuk ka qenë i riklasifikuar, kjo diferencë regjistrohet në rezultat.
  - (f) norma efektive e interesit dhe shumat e parashikuara të flukseve që njësi pret të rikuperojë, në datën e riklasifikimi të aktivit financiar.

#### Data efektive e kalimit

- 44E *Riklasifikimi i Aktiveve Financiarë* (Ndryshime për SNK 39 dhe SNRF 7), i publikuar në Tetor 2008, paragrafi 12 është ndryshuar dhe është shtuar paragrafi 12A. Një njësi do t'i aplikojë këto ndryshime nga data 1 Korrik 2008.